

MATERIALE DHE DOKUMENTE**VALTER MEMISHA****FRAZELOGJIA NË TRI DRAMA TË DRITËRO AGOLLIT**

Universi letrar i Dritëro Agollit ka mundësuar dhe mundëson analiza, kundrime e studime të shumta, të veçanta apo përfshirëse, paraqitëse apo të thelluara, të lidhura me çështje të përmbajtjes apo me ato të shprehjes gjuhësore. Në trajtesat e realizuara, si kudo, por edhe për këdo që i përket fushës së shkrimtarisë, rrafshi i përmbajtjes të vepra e këtij autori është më i rrahuri dhe më i analizuari, edhe pse studimet nuk janë kurrë të fundme dhe krejt natyrshëm, kurrë shteruese. Gjuha e veprave letrare - artistike në studimet tona, përgjithësisht, ka mbetur paksa si jetime, edhe pse kohët e fundit janë bërë përpjekje për të kapërcyer hendekun e krijuar (janë hartuar disa punime e janë mbrojtur teza doktoratash).

Gjuha e Agollit është vetjakësuar tashmë, ashtu si është vetjakësuar gjithë prurja e tij letrare-artistike. Dhe kjo për vlerat e gjithanshme që mbart. Akademiku J. Thomai thekson se “Për çfarë shkruan Dritëroi? Për gjithçka njerëzore, për çdo motiv popullor: për njeriun e mirë, për baballarët, për të parët tanë e për të rinjtë e sotëm, për zemrat e bardha e shpirtrat e dashuruar, për heronjtë, për shokët e miqtë, për dashurinë njerëzore e pastaj për Shqipërinë, për fushat e gjelbra e arat me misër, për baltën e fshatit, për rrugët plot jetë, për lulet dhe zogjtë, e për gjithçka na rrethon e përbën jetën tonë...”¹. Dhe po ky studiues, kur fokusohet te natyra gjuhësore e krijimtarisë së poetit, shprehet se “Ligjërimi letrar i Dritëroit është popullor jokrahinor, nuk mund të thuhet se ai shkruan “devolliçe”, siç mund të thuhet për një tjetër që shkruan labçe, dibrance a shkodranisht. Ngjyrimi popullor i ligjërimin poetik të Dritëroi mund të dëshmohet qoftë edhe me leksikun karakteristik të përdorur.”²

¹ J. Thomai, *Aromë popullore në ligjërimin poetik të Dritëro Agollit*, në “Dritëro Agolli *Doctor Honoris Causa*” (Përmbledhja e materialeve të Konferencës kushtuar shkrimtarit dhe akademikut D. Agolli me rastin e dhënies së titullit *Doctor Honoris Causa* nga Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës në 80-vjetorin e lindjes), Korçë, 2012, f. 18.

² J. Thomai, *po aty*, f. 18.

Në shumë intervista Dritëro Agolli është shprehur për vlerat e shumta dhe pasurinë e pashtershme të gjuhës së popullit. Vetë ai nënvizon: “Këngët, vallet, tingujt dhe ritmet kanë të bëjnë me gjuhën, se në to dëgjohet edhe fjala shqipe. Këtë duhet ta ketë parasysh gjithmonë shkrimtari, nëse do që të mos e thajë gjuhën e tij. Gjuhën duhet ta mbajë me lëng dhe lëngu vjen nga gjuha e popullit. Unë gjithmonë shënoj në fletore fjalë të popullit, shprehje dhe frazeologji.”³

Në këtë hulli ecën dhe punimi ynë, i cili ndalet te frazeologjia si njësi ndërtuese e kohezionit gjuhësor të tri dramave të ardhura te lexuesi në tetor 2016, në 85-vjetorin e ditëlindjes së shkrimtarit: *Fytyra e dytë, Moshë e bardhë, Baladë për një grua*⁴. Dramat erdhën te ne pas një pune përkushtuese të prof. Shaban Sinani, i cili bëri të pamundurën që ato të shihnin dritën e botimit dhe të mos mbeteshin në raftet e bibliotekave të institucioneve të interpretimit skenik (madje *Baladë për një grua* nuk u vu asnjëherë në skenë, për shkak edhe të zhdukjes së tekstit).

Nga një punë e drejtpërdrejtë mbi tekstet e këtyre dramave, ne kemi vjelë 437 njësi frazeologjike në rreth 500 përdorime (më saktë: 491), me statistikën vijuese: në dramën “Fytyra e dytë” (85 faqe): 209 njësi; në dramën “Moshë e bardhë” (111 faqe): 177 njësi (rreth 25 faqe më e vëllimshme se drama e parë, por me 32 njësi frazeologjike më pak se ajo); në dramën “Baladë për një grua” (84 faqe): 105 njësi (te kjo dramë numri i njësisve frazeologjike bie në mënyrë drastike, gjysmë për gjysmë. Mbase më shumë se kudo në këtë vepër kemi një drunjëzim të ligjërimit artistik, aq sa kur e lexon, të lodh, edhe pse artistikisht konflikti (intriga, - shprehet studiuesi Sh. Sinani) është i mirëzgjidhur.

Le të ndalemi në disa veçori të kësaj frazeologjie:

1. Tashmë nuk themi asgjë të re, nëse theksojmë se frazeologjia është pjesë e pandarë e kohezionit gjuhësor të çdo vepre letrare. Por te vepra e Dritëroit frazeologjia ka peshë jo të vogël, aq sa prurjet e tij unë do t’i përqsajja me prurjet e M. Camaj në këtë fushë. Por të tri dramat nuk gjejmë atë pasuri frazeologjike, që ka pjesa tjetër e krijimtarisë së këtij autori, sidomos në prozë e në vepra si *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, Arka e djallit, Njeriu me top* etj. Dramat e Dritëro Agollit, pa hyrë hollësisht në rrafshin e vlerave përmbajtësore, gjuhësisht nuk e kanë nivelin e poezisë dhe të prozës së tij. Mendoj se mbase autori ka hyrë në dramë më shumë i shtyrë nga kërkesat institucionale se duhej të krijonte dhe në këtë gjini, më shumë për të plotësuar mungesën e veprave dramatike në letërsinë e realizmit socialist, çka vërehet lehtësisht edhe te skematizmi i ndërtimit të subjekteve apo te drunjëzimi i shpeshtë i ligjërimit të personazheve. Po japim një shembull të këtij drunjëzimi:

³ D. Agolli, në “Jeta në letërsi”, Tiranë, 1987, f. 278.

⁴ D. Agolli, *Tri drama: Fytyra e dytë, Moshë e bardhë, Baladë për një grua*, Tiranë, 2016.

FATBARDHA *Ti je një robot i telekomanduar nga Kamani. Po, Arsen, po. Harmoni do të thotë të kesh të njëjtat mendime, të njëjtat ideale, të njëjtat shije, të njëjtët miq. Ne këto mjerisht nuk i kemi më. Dashuri ka atëherë kur burri e gruaja i rrezatojnë shoku-shokut ndjenja të bukura dhe respekt. Ti Arsen nuk rrezaton më. Ke shtrirë personalitetin tënd nën këmbët e Kaman Kalasë. Ti harron sa je bërë shkencëtar i shquar jo sepse ke pasur miqësinë e Kamanit. Në të kundërtën, Kamani të është bërë mik sapo u bërë i shquar. Ai të ka marrë me vete në konferencat ndërkombëtare nëpër Europë jo se të ka mik, po se ti e meriton. Zbulimet e tua ti i ke bërë për vendin, për popullin e jo për miqësinë e Kamanit. Ti e ke humbur toruan. Disa minuta më parë refuzove ftesën që të bënë miqtë e vjetër të fshatit për festën e stacionit të ri. Ata nuk e dinë se ti nuk je më ai i pari. Ty tani të pëlqen t'i kalosh mbrëmjet me shokun Kaman. Harron që në këto lartësi të ngritën përpjekjet e tua, të jetuarit pranë bujqve të thjeshtë, specialistëve të fshatit e shkencëtarëve të tjerë. Harron që në një rrënjë misri më shumë ke derdhur ti djersë se sa qielli shi e vesë. Dhe tani duke i harruar këto, trembesh se, po të humbësh miqësinë e tij, i humbet të gjitha. E në këtë botë të vockël ku ke hyrë tani rron si frikacak, pa mendim e pa kurajë. E në këtë botë të vockël kërkon të më tërheqësh edhe mua. Po unë nuk të vij, e ky është konflikti ynë. Kjo është ftohja jonë. Se unë nuk bindem të ulem në një kanape me Kikinë, ku të qajmë hallet zonjat se përse ky shteti ynë i proletarëve nuk ngre më shumë fabrika kozmetike e punishte për breçka me dantella.*⁵

2. Një vepër letrare kërkon jo vetëm hedhjen me një frymë në letër të asaj që është ngjizur në tru, por edhe latimin e rilatimin, tëharrjen e krehjen, plotësimin e nisjen për udhë të lexuesi edhe të mirëveshur dhe gjuhësisht. Nga kjo anë dramat e Agollit dallojnë jo pak. “Fytyra e dytë” është më e realizuar nga dy të tjerat, edhe për faktin se është riparë e ripunuar nga autori si tekst letrar. Gjuhësisht, te kjo vepër gjejmë një numër të vlerësueshëm njësisish frazeologjike, edhe për faktin se është e lidhur më shumë se dy dramat e tjera me natyrën popullore të ligjërimin letrar të autorit.

3. Dritëroi ka shkruar vetë se “Gjuhëtarët e dinë mirë se studimi i gjuhës artistike të një veprë letrare të jep përfytyrimin e një periudhe të tërë të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës së popullit, të fjalës së folur në atë kohë, të mënyrës së jetesës dhe të menduarit të klasave e shtresave dhe grupeve shoqërore, megjithëse gjuha nuk është superstrukturë. Mënyra e jetesës dhe e të menduarit të klasave, shtresave dhe grupeve shoqërore në veprat letrare ka lënë gjurmë, sidomos në ngjyrën shprehëse të fjalës, në ndryshimin e ngjyimeve sipas kohës. Dramat sjellin një pasuri leksikore dhe frazeologjike që na çon në vitet ’70 të shekullit të kaluar.

⁵ D. Agolli, *Tri drama: Fytyra e dytë, Moshë e bardhë, Baladë për një grua*, Tiranë, 2016, f. 230.

Gjuha e dramave ngjyroset shumë shpesh me koloritin popullor. Do të përdalloja vetëm dy dukuri që bien në sy:

a. Aty gjejmë fjalë me ngjyrim të theksuar dhe kjo shpërfaqet, sidomos, kur autori përdor huazime: *zorzop* (Zonja Zyhra, ç'është ky **zorzopi** që i bie qitharës tashti natën, sikur mbledh të gjithë xhindet? (f. 16); *karagjoz* (Mos u bëj **karagjoz**.) (f. 15); *kaparos* (Premë ditën e dasmës, ftuam soj e sorollop, **kaparosëm** edhe sazexhinjtë.) (f. 18); *aguridhe* ("S'je bërë akoma ti, **aguridhe**, që t'i nxish faqen Halil Shkozës!) (f. 18); *hergjele* (Dhe t'u lëshojmë frerët këtyre **hergjeleve**?) (f. 19) etj., etj.

b. Sjell fjalë dhe shqiptimet dialektore: *mollokrepsem*, *sojzezë*, *elektrixhi*, *qitharë* (*Me kë je mollokrepstur, moj sojzezë, me elektrixhiun që ka filluar t'i vijë rrotull shtëpisë?*; *Zonja Zyhra, ç'është ky zorzopi që i bie qitharës tashti natën, sikur mbledh të gjithë xhindet?*) (f. 16).

4. Por ngjyrosja popullore shpërfaqet te frazeologjia. 500 njësitë e vjela, edhe pse mund të jenë stilizuar, zgjeruar a kondensuar, të përdorura herë të asnjansuara, herë të markuara e herë të mbimarkuara emocionalisht, ato në thelb janë marrë nga goja e popullit dhe janë përdorur artistikisht. Frazeologjia ngjizet në breza dhe aftësia e mundësia e krijimit të tyre nga një autor (ndryshe nga fjalëkrijimi), qoftë dhe i përmasave të Dritëroit, është tepër-tepër minimale. Në dramë vijnë frazeologji, që tregojnë dhe origjinën e autorit por edhe kompetencën e tij për t'i përdorur ato me art. Akademiku Gj. Shkurtaç shkruan se "Trevë e Devollit paraqet interes të madh gjuhësor. Devolli është një krahinë me një folklor të pasur, gjë që dëshmon ndjeshmërinë e lartë të këtij populli. Leksiku, frazeologjia dhe fjalët e urta të asaj krahine, bashkë me toponiminë e saj të larmishme përbënin pa dyshim vlera të kulturës popullore dhe të gjuhës shqipe, me të cilat Dritëroi jo vetëm u ushqye, por edhe mbeti përjetësisht i lidhur e nuk rreshti asnjëherë së qëmtuari e së përzgjedhuri si bleta në lulet e pranverës."⁶ Lënda në vijim, edhe pse ka natyrë klasifikuese e tipologjizuese, e tregon këtë vlerë të spikatur të penës së Agollit.

5. Frazeologjia e qëmtuar në të tri dramat të marra si një tekst i vetëm, mund të grupohet sipas përkatësisë burimore të gjymtyrës motivuese:

a. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë *një emërtim për pjesë të trupit të njeriut*: *Ti vetë ia prishe zemrën të birit të botës për vogëlsira.* (f. 26); *Gjisht të bukur që paska!* (f. 16); *Iu bënë sytë ujë, të ziut!* (f. 17); *Qëkur na ndodhi ajo gjëma, iu prish gjaku e mori poshtë e më poshtë.* (f. 17); *Po ti, moj çupë e xhaxhait, ç'm'i ke varur buzët?* (f. 21); *Ke punuar me mend, i ke gjetur një*

⁶ Gj. Shkurtaç, "Balta e arave" si shtegu i prurjeve gjuhëpasuruese dhe gjuhëdashëse të Dritëro Agollit, në "Dritëro Agolli Doctor Honoris Causa (Përmbledhja e materialeve të Konferencës kushtuar shkrimtarit dhe akademikut D. Agolli me rastin e dhënies së titullit Doctor Honoris Causa nga Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës në 80-vjetorin e lindjes)", Korçë, 2012, f. 20.

basho vend, me forcën e krahut tënd! (f. 21); *Të lumshin këmbët.* (f. 22); *De, mos e prish gojën,* zoti Halil, është çupa e shokut të ngushtë të Bektashit. (f. 24); *As Andrea, as Kristina, nuk ka pse merren nëpër gojë.* (f. 24); *Ngadonjëherë miqësia që kemi na zë sytë dhe nuk na le të shohim fenomenet që na rrethojnë.* (f. 24); *M'u hap koka.* (f. 132); *Djali i sëmurë, nusja sa them unë një fjalë zë e zbardh dhëmbët.* (f. 132); *Të shoh si të prishur në fytyrë.* (f. 133)

b. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një emërtim nga bota e kafshëve: *Prit gomar të mbijë bar.* (f. 14); *Demek, t'ua lëshojmë frerët e të kullosin nga të duan!* (f. 19); *Me sa duket, mbrëmë ke rënë të flesh që me pulat.* (f. 267)

c. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një emërtim nga sfera e kulturës: *Mos u jep ngjyrë komike* problemeve. *Bektash, po më flet nga kulla e lartë e njeriut me përgjegjësi.* (f. 12)

d. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një emërtim nga zhvillimi bashkëkohor industrial, shkencor i vendit etj.: *Fakt i pamohueshëm, njeriu qenka një minierë e thellë.* (f. 14); *Hë, më të keqen Halili, si qenka ngjitur fütili!* (f. 21); *Ti je një robot i telekomanduar nga Kamani.* (f. 230); *Gjendja jote shpirtërore është në një pikë të vdekur.* (f. 172); *Arianën e sjell unë në binarë!* (f. 31)

e. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një emërtim një fjalë dëftuese (që emërton dukuri të kohës së monizmit): *Nga një derë me biografi të mirë.* (f. 18); *Tani le ta mbajë, se, po ia mora, më prish biografinë!* (f. 239); *Unë në këto çaste jam një i pushkatuar politikisht.* (f. 268)

f. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një emërtim nga fusha e zejtarisë: *Do t'i ngelet gozhdë xhaxhait po s'të njohu!* (f. 22); *Na bluan ky qerrata mulli, na bluan dhe nuk e dimë se ç'miell nxjerrim.* (f. 27); *Njeri me dërraskë në kokë!* (f. 30); *Dru u regjur domethënë, i stazhionuar.* (f. 154)

g. Njësi frazeologjike me një gjymtyrë një huazim turk: *Për çupën e Andreas u fol kot. Ujë në havan.* (f. 12); *Drejtoni ju, apo tundni zinxhirin?* (f. 14); *Çorbë nuk do t'i bëjmë mbledhjet.* (f. 12); *Ne duam që vajzat tona t'i fusim në kallëpin e rehatit.* (f. 11-12); *Mos u bëj karagoz.* (f. 15); *Na bëre çirak me këta limonë, Ndreko!* (f. 133)

h. Njësi frazeologjike që lidhen me fushën e besimit fetar: *Ju kujtoni se Kaman Kalaja u demaskua nga fryma e shenjës?* (f. 274)

6. Grupimi konceptor i njësive frazeologjike:

A. Njësi frazeologjike me ngjyrim pozitiv.

a. Njësi që lidhen me një vlerësim moral: *Fejuar de, fejuar, me një djalë nga derë e mirë.* (f. 18) *“Po ku gjen djalë më të mirë se Hyska i Selos, moj: me familje të mirë, me vëllezër të martuar, me një baba që nxjerr mjaltë nga goja”.* (f. 18); *Por ajo është një grua që i ka shoqet të rralla.*

a. Njësi që lidhen me punën: *Më mirë t'i vëmë shpatullat punës dhe të mos merremi me vogëlsira.* (f. 77)

c. Njësi që lidhen me dashurinë: *Po dashuria nuk ka brirë.* (f. 26)

d. Njësi që lidhen me etikën e mirësjelljen: *Emrin e Arianës nuk e shoh të nevojshme ta zëmë në gojë.* (f. 77); *Ajo ty do të të mbajë në pëllëmbë të dorës.* (f. 114)

e. Njësi që lidhen me një këshillim: *Ti duhet të shërohesh nga mendtë, moj bijë.* (f. 32); *Thuaji se ka luajtur mendsh.* (f. 33) *Ti me Muhametin do të bësh jetë, me tërë kuptimin e fjalës.* (f. 34);

d. Njësi që lidhen me një urim: *Të bëftë mirë, zoti Halil!* (f. 39)

B. Njësi frazeologjike me vlerësim negativ.

a. Njësi që tregojnë mallkim: *I ardhhtë qafa mbrapa!* (f. 16)

b. Njësi që tregojnë inat, zemërim: *“S’je bërë akoma ti, aguridhe, që t’i nxish faqen Halil Shkozës!* (f. 18); *Drejtoni ju, apo tundni zinxhirin?* (f. 14)

c. Njësi që tregojnë keqardhje: *Qëkur na ndodhi ajo gjëma, iu prish gjaku e mori poshtë e më poshtë.* (f. 17); *Ti vetë ia prishe zemrën të birit të botës për vogëlsira.* (f. 26); *Do t’i bjerë të mirës me shqelm.* (f. 34); *Kalli pa bukë!* (f. 40)

d. Njësi që tregojnë besëtytni: *Zonja Zyhra, ç’është ky zorzopi që i bie qitharës tashti natën, sikur mbledh të gjithë xhindet?* (f. 16); *Çupa e Andreas nuk hodhi fall se do emërohej në Laç.* (f. 11); *Ky Hyska, moj Zyhra, si i rënë nga qielli.* (f. 18)

e. Njësi që tregojnë mërztitje: *Po ti, moj çupë e xhaxhait, ç’m’i ke varur buzët?* (f. 21); *Ti derën tonë po e vulos me një vulë të ligë, që s’fshihet kurrë.* (f. 32); *“Me kë je mollokrepur, moj sojzezë, me elektrixhiun që ka filluar t’i vijë rrotull shtëpisë?”.* (f. 18)

f. Njësi që tregojnë tallje: *M’u ngritën mustaqet përpyjet!* (f. 239); *Pyll pa derra s’ka...* (f. 239); *Prit gomar të mbijë bar.* (f. 14)

g. Njësi që tregojnë neveri: *“Ai që më keni zgjedhur ju mua më kall krupë”, më thotë.* (f. 18)

h. Njësi që tregojnë thashetheme: *Ariana ka kohë që bën dashuriçka me një pizeveng në kantierin e ndërtimit, me një farë Aleks Kola.* (f. 29)

7. Në tri dramat e D. Agollit, kanë zënë vend edhe shumë fjalë të urta që shpesh dalin me funksionin e një njësie frazeologjike. Këto fjalë të urta shpesh stilizohen, u thyhen kufijtë, u prishet strukturën, perifrashohen: *Edhe sikur t’ia ketë vënë vetë zjarrin mjekrës, ne nuk duhet të ndezim cigaren.*; *Mua kjo s’m’u durua pa e thënë, për të treguar atë që karvani të shkojë përpara, pa qentë le të lehin.* (f. 242); *Kur e ke tokën të lëruar, e gjen dhe farën.* (f. 42) *E lëron tokën dhe e humbet farën (hedh sytë nga shishja e rakisë, Zyhraja përgatit tavolinën).* (f. 42); *Atij i digjet mjekra, unë shkoj të ndez cigaren!* (f. 268); *Kripa në tokë, peshku në det, po një tigan i bashkon.* (f. 42)

Duke ua lënë vendin njësive frazeologjike të vjela nga vepra dramaturgjike e shkrimtarit të madh, po i mbyllim këto ravijëzime për një studim të mëtejshëm të plotë duke dhënë një vlerësim për të, hedhur në letër

nga akademikja Floresha Dado: “Vepra e Agollit, duke qenë në grupin e autorëve më të shquar të letërsisë shqiptare, përcjell gjithnjë mesazhe njerëzore, parime të një morali dhe marrëdhënieje të qytetëruar. Përmes një komunikimi origjinal, herë përmes humorit, herë përmes dëshpërimit njerëzor, herë përmes afirmimit të idealeve sociale, shkrimtari ynë ndërton një marrëdhënie krejt të veçantë me shqiptarët e tij, ku mbizotëron, nga njëra anë thjeshtësia, mënyra e drejtpërdrejtë e shprehjes, nga ana tjetër filozofia e thellë njerëzore mbi thelbin e jetës dhe të njeriut. Është pikërisht kjo filozofi e brendshme, që vjen thjesht e pa bujë, që depërton në shpirtin tonë.”⁷

Në vijim po japim lëndën frazeologjike, të vjelë nga botimi “D. Agolli, *Tri drama: Fytyra e dytë, Mosha e bardhë, Baladë për një grua*, Tiranë, 2016”. Përgjithësisht njësitë janë të njohura për lexuesin, pra semantikisht janë të qarta e të kuptueshme, duke zënë vend pothuaj të gjitha në frazeologjinë normative të shqipes standarde. Ndaj, për të mos rënduar materialin që po botojmë, menduam që ato të mos jepen me shpjegim kuptimor. Njësitë frazeologjike (por dhe disa njësi që nuk janë të tilla, por janë përfshirë sepse shenjohen figurshëm dhe janë në proces frazeologjizimi) bëhen tregues i një veçorie të spikatur të kohezionit gjuhësor të tri dramave dhe të vetë gjuhës së veprave artistike të autorit. Por ato, njëkohësisht mund të shërbejnë si lëndë mbi të cilën mund të bëhen sipërmarrje të mëtejshme nga kushdo që merret apo që do të merret dhe me këtë veçori të veprave të shkrimtarit D. Agolli.

(Di) si kapet bilbili: *E di xha Halili si kapet bilbili!* (f. 47)

(Dhembin) si gishtat e dorës: *Edhe dhjetë të kesh, njësoj të dhembin, si gishtat e dorës.* (f. 130)

(Jam) një i pushkatuar politikisht: *Unë në këto çaste jam një i pushkatuar politikisht.* (f. 268)

(Jam) i zhytur në punë: *Dhe kjo ndodh ngaqë unë jam i zhytur në punë dhe nuk kam kohë që të merrem me fenomenet e vogla të jetës.* (f. 29)

(Është) i dorës së dytë: *Gabimet e tua ndaj meje janë vërtet të rënda, edhe pse janë të dorës së dytë.* (f. 278)

Me soj e sorollop: *Premë ditën e dasmës, ftuam soj e sorollop, kaparosëm edhe sazexhinjtë.* (f. 18)

⁷ F. Dado, *Vlerësim mbi personalitetin e Dritëro Agollit*, në “Dritëro Agolli Doctor Honoris Causa” (Përmbledhja e materialeve të Konferencës kushtuar shkrimtarit dhe akademikut D. Agolli me rastin e dhënies së titullit Doctor Honoris Causa nga Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës në 80-vjetorin e lindjes), Korçë, 2012, f. 8-9.

(Ngjajnë) si dy pika uji: *Ky dhe Fatbardha ngjasin në bisedë si dy pika uji!* (f. 218)

(Shkrin) si dëbora në pranverë *Një filozof ka thënë: "Kur dashuria e gjen fatin menjëherë, shkrihet si dëbora në pranverë".* (f. 88)

Ai që hyn në ring, duhet t'i mendojë grushtet. *fj. u. Ai që hyn në ring, duhet t'i mendojë grushtet.* (f. 222)

Aq ma pret: Po ty aq ta pret! (f. 38)

As hiqesh, as ngjitesh: Ti as hiqesh, as ngjitesh. (f. 79)

As në të thatë, as në të njomë: Unë nuk desha të ta thosha, por me Arianën nuk jam as në të thatë, as në të njomë. (f. 58)

Bëhem bilbil nga goja Të jetë si ty dhe Halili, nga goja bëhet si bilbili... (f. 20)

Bëhem karagjoz: Mos u bëj karagjoz. (f. 15)

Bëhem merak: Po ti mos u bëj merak. (f. 36)

Bëhem qengj: U bë qingj Fredi im! (f. 181)

Bëhem sebeb: Unë u bëra sebeb. (f. 26)

Bëhet gruaja e dikujt: Se nuk do të bëhem kurrë gruaja e tij. (f. 33)

Bëhet qaraman: Omer, mos u bëj qaraman. (f. 256)

Bëj be e rrufe: Ka bërë be e rrufe! (f. 73)

Bëj bujë: Unë lexoj vetëm autoritete e vetëm pasi kanë bërë bujë, kurse kjo i hap librat pa iu tharë boja e shtypshkronjës. (f. 201)

Bëj celebrimin: E kam fjalën më shumë për Martinin, meqë edhe vetë më je hapur para se të bënim celebrimin. (f. 131)

Bëj çirak: Na bëre çirak me këta limonë, Ndreko! (f. 133)

Bëj dashuriçka: Ariana ka kohë që bën dashuriçka me një pizeveng në kantierin e ndërtimit, me një farë Aleks Kola. (f. 29)

Bëj dy koqe muhabet: Po ulu të bëjmë dy koqe muhabet, jemi të njëri-tjetrit. (f. 22)

Bëj estradë: Dëgjo, Temo Konduri, me mua mos bëj estradë! (f. 252)

Bëj gabim: Mendohu prapë, mos i thuaj gjë Muhametit, mos e bëj këtë gabim. (f. 34)

Bëj hatanë: Eh, i urtë, more i urtë, po ka ca damarë njeriu që, po i kërcyen, bën hatanë (çiften e ka harruar në dorë). (f. 235)

Bëj jetë qeni: Të rrish te xhaxhai do të thotë të bësh jetë qeni. (f. 110)

Bëj jetë: Ti me Muhametin do të bësh jetë, me tërë kuptimin e fjalës. (f. 34)

Bëj kërدينë: Thashë de, se meazallah hapet ndonjëra e bën kërدينë... (f. 130)

Bëj muhabet: S'na le të bëjmë muhabet me këtë të shkretë kitarë. (f. 186)

Bëj naze: I bën ca naze Kamber Shtikës dhe ai luan mendsh. (f. 108)

Bëj ndonjë proçkë: *Të bëjë ndonjë proçkë* kjo çupa jote një javë para dasmës, pa llafosemi bashkë. (f. 27)

Bëj punë me mend: *Do të bëj një punë me mend:* do të të lë një copë herë dhe me familjen. (f. 201)

Bëj punë të liga: *Një palo inxhinier, një nul para tyt eti, po bën shumë punë të liga.* (f. 38)

Bëj shaka me kripë: *Bëj shaka, por jo pa kripë.* (f. 132)

Bëj shaka: *Mos bëj shaka, se po më luan mendsh.* (f. 51)

Bie erë: *Ne jemi pak rrëmujë si beqarë, / Do rrjedhë koha, s' do rrojmë në rrëmujë, / Se gra të mira kemi për të marrë / Dhe apartamentet do bien erë ujë!* (f. 87)

Bie në dashuri: *T'i shohë njeri që nuk i njeh, kujton se këta të dy kanë rënë në dashuri.* (f. 110)

Bie në krahët e dikujt: *Mos mendo se ti je yll dhe ne femrat presim sa të hapësh gojën e të biem në krahët e tu:* "Aman, o Agush, na puth me buzët e tua, se plasëm!" (f. 109)

Bie në kurth: *Zalo Zangali nuk bie në kurthe dexhenerimi!* (f. 102)

Bie nga shkallët: *Do të bija nga shkallët?* (f. 164)

Bie poshtë: *Ku ke rënë, Fredi, ku ke rënë!* (f. 142)

Bie të fle me pulat: *Me sa duket, mbrëmë ke rënë të flesh që me pulat.* (f. 267)

Blej mend: *Fshesën e blen, po mendtë s'i blen, Bato Barmashi.* (f. 93)

Çelësat e kasafortës: *Rita e rrëzoi perandorinë e Marikës, i mori qeverisjen e shtëpisë, çelësat e kasafortës së shtëpisë i shtiu në dorë Rita, se ajo është forcë prodhuese.* (f. 160)

Çështje kalibri: *Qenka çështje e kalibrin!* (f. 20)

Ç'më sheh syri, më bën dora: *Ç'i sheh syri, i bën dora.* (f. 120)

Dal nga tema: *Kot u përpoqët që të dilni nga tema.* (f. 56)

Dashi me rudën: *Dashi me rudën-* na prishin mbrëmjen dhe gjithë humorin, Omer! (f. 212)

Derdh djersë: *Dëgjo, Agush, unë e kam ndjerë aromën e punës dhe kam derdhur pak djersë.* (f. 113)

Derë e mirë: *Fejuar de, fejuar, me një djalë nga derë e mirë...* (f. 18)

Diktatura e proletariatit: *Domethënë, diktatura e proletariatit s'po na vjen.* (f. 216)

Djalë pa mend: *Alexi nuk është djalë pa mend.* (f. 49)

Dobësimi i nervave: *Përveç të këqijave të prishjes së gjakut dhe dobësimi të nervave, objektivist asgjë të mirë nuk sjellin këto thashetheme.* (f. 62)

Doçkë e hekurt: *Kjo tregon se gruaja e Omerit duhet të jetë doçkë e hekurt në shtëpi.* (f. 219)

Dogmë e gjallë: *Unë jam ftohur më ty, se ti je një dogmë e gjallë.* (f. 229)

Dredh bishtin: *E dredh bishtin, e dredh.* (f. 41); *Ja, kjo Bajramja që sheh ti, kjo grerë e fshehur nën këmishë, e dredh bishtin, e dredh!* (f. 41)

Dru i regjur: *Dru i regjur domethënë, i stazhionuar.* (f. 154)

Dru i stazhionuar: *Dru i regjur domethënë, i stazhionuar.* (f. 154)

Dy e dy bëjnë katër: *A mund të thuash: "Nuk e di pse dy e dy bëjnë katër?"* (f. 170)

Dhëmb për dhëmb: *Ky njeri, që lufton dhëmb për dhëmb me bllokadën dhe triumfin e socializmit, ka bërë aktin më të madh moral.* (f. 221)

E bardha zemër: *Kur të të dojë e bardha zemër.* (f. 65)

E bëj çorbë: *Çorbë nuk do t'i bëjmë mbledhjet.* (f. 12)

E bëj perëndi: *Këtë Martinin tënd mos ma bëj perëndi!* (f. 179)

E bukur te zoti: *Të them të drejtën, e bukur te zoti!* (f. 92)

E do vjehrra: *Të paska dashtë vjehrra.* (f. 22)

E hedh në dorë: *Madamë Hi-hi e ka hedhur në dorë Kamber Shtikën!* (f. 108)

E heq për dore: *Ti më hiqje për dore mua.* (f. 237)

E ka derën hapur: *Derën hapur e kanë, le të urdhërojnë.* (f. 131)

E ka origjinën nga ngjala: *Sikur ta kish origjinën nga ngjala.* (f. 70)

E kam krah të fortë: *E ke krah të fortë të zotin e shtëpisë.* (f. 45)

E kam mendjen top: *Edhe sikur të mblidheni të gjithë, unë mendjen e kam top.* (f. 262)

E kam rrugën të hapur: *Rrugën e ka të hapur.* (f. 102)

E kam të butë pëllëmbën: *Ti e ke mjaft të butë pëllëmbën.* (f. 241)

E kap demin për brirësh: *Sidoqoftë, ti duhet t'i shkruash Aleksit që t'i vërë gishtin kokës, të mbledhë mendjen e të punojë, ta kapin demin për brirësh!* (f. 49);

E kap për brirësh: *Kështu thotë dhe kryetari i kooperativës sonë, ta kapim për brirësh.* (f. 49)

E kërkon nga goja ime: *A kërkon të dish të vërtetën nga goja ime?* (f. 89)

E marr me mend: *Eh, Agush, ti nuk e merr me mend sa gjë të keqe bën duke trilluar konflikte të paqena!* (f. 180)

E marr më qafë: *Mua më ka marrë më qafë Kamani.* (f. 265); *Edhe Arsenin ai e ka marrë më qafë!* (f. 265)

E marrtë dreqi: *Dreqi ju marrtë!* (f. 102); *Gjithë shtëpia në tension, dreqi ta marrë!* (f. 140); *Të marrtë dreqi!* (f. 237)

E mbaj në pëllëmbë të dorës: *Ajo ty do të të mbajë në pëllëmbë të dorës.* (f. 114)

E mbulon një hije e errët: *Kot së koti e mbulon njeriun një hije e errët.* (f. 96)

E mori mortja: *E marrtë mortja Bektashin me këto kritika!* (f. 67)

E mori Shkumbini: *Dhe vërtet të mori Shkumbini.* (f. 157)

E pjek kokën me dikë: *Po e poqi kokën me Niko agronomin, hajde të ndahet.* (f. 200)

E prish me dorën time: *Dhe tani çdo gjë e prish me dorën tënde.* (f. 34)

E prish me duart e mia: *Në të vërtetë ne nuk u bëjmë mirë, se ua prishim të ardhmen me duart tona.* (f. 12)

E prishi gojën: *De, mos e prish gojën, zoti Halil, është çupa e shokut të ngushtë të Bektashit.* (f. 24)

E sjell në binarë: *Arianën e sjell unë në binarë!* (f. 31)

E solli kokën: *E solla, që mos e sjell të kokën!* (f. 39)

E vë në pozicion të vështirë: *Jam një i përjashtuar nga partia dhe nuk dua t'i vë shokët në pozita të vështira, prandaj...* (f. 268)

E zë demin nga brirët: *Po ta zemë njëherë demin nga brirët.* (f. 207)

E zhdëp në dru: *E kam zhdëpur në dru.* (f. 41); *Ta zesh Arsenin e ta zhdëpësh në dru...* (f. 242)

Edhe speci është i vogël, por djeg fj. u.: *Edhe speci është i vogël, por djeg.* (f. 41)

Është gjithë nerva: *More, po çfarë ke, që je gjithë nerva.* (f. 28)

Është në të: *More, ky Agushi është në të apo ka lajthitur?* (f. 94)

Është ngritur shkalla e termometrit: *Dale, thashë, s'është ngritur shkalla e termometrit gjer në atë pikë!* (f. 92)

Është shëruar nga mendtë: *Ti duhet të shërohesh nga mendtë, moj bijë.* (f. 32)

Fjalët i merr era fj. u.: *Fjalët i merr era, shifrat mbeten!* (f. 192)

Flas me thumba: *Vetëm Martini me Faten në një moment nuk më pëlqyen, se flisnin me thumba për ty e për mua.* (f. 114)

Flas nga kulla e lartë: *Bektash, po më flet nga kulla e lartë e njeriut me përgjegjësi.* (f. 12)

Flas prapa krahëve: *Dhe Martini nuk foli keq prapa krahëve për ty.* (f. 183)

Fryma e shenjtë: *Ju kujtoni se Kaman Kalaja u demaskua nga fryma e shenjtë?* (f. 274)

Furrik i ngrohtë: *Është një zog që ëndërron furrik të ngrohtë.* (f. 95)

Fut hundët në punët e të tjerëve: *Fate, të vish mik në shtëpi nuk do të thotë të futësh hundët në punët e të tjerëve.* (f. 154)

Fut hundët: *Ne nuk do të fusim hundët edhe në fenomenet thjesht shpirtërore...* (f. 63); **Ti i fute hundët në projekt.** (f. 156); **I fute hundët pasi ishin hedhur themelet.** (f. 156)

Futem në vrimë të djallit: *Edhe në vrimë të djallit të futesh ti, të gjejnë.* (f. 205)

Gënjem sy ndër sy: *Ti ke aftësi të gënjuhesh sy ndër sy.* (f. 156)

Goditje përqendruar: *Tani bëj një goditje të përqendruar për të prishur atë që fillove me goditjen e parë të përqendruar.* (f. 157)

Grerë e fshehur: *Ja, kjo Bajramja që sheh ti, kjo grerë e fshehur nën këmishë, e dredh bishtin, e dredh!* (f. 41)

Grij fjalë: *Por njerëzit grijnë fjalë, na thurin dhe ne thashetheme, jo më juve, të rinjve.* (f. 36)

Gjej gjuhën e përbashkët: *Ç'gjuhë të përbashkët gjen me Agushin?* (f. 94); *Vërtet, ç'gjuhë të përbashkët gjen?* (f. 94)

Gjen cipën e hollë: *Mbeturinat gjejnë cipën e hollë, e çajnë dhe futen...* (f. 26)

Gjen qimen në vezë: *Ky kërkon të gjejë qimen në vezë!* (f. 217)

Hedh fjalë: *Unë ta përmend këtë sepse për atë shoqërinë tuaj budallaqe janë hedhur ca fjalë.* (f. 132)

Hedh një hap të gabuar: *Po hedh një hap shumë të gabuar.* (f. 51)

Hedh sytë: *E lëron tokën dhe e humbet farën (hedh sytë nga shishja e rakisë, Zyhraja përgatit tavolinën).* (f. 42); *Fredi (hedh sytë nga shishja): Do t'ia shtrojmë sonte, ë?* (f. 99)

Hedh vickla: *Në vend që të gëzohesh për ikjen e Martinit, hedh vickla.* (f. 184)

Hedhë themelet: *Pas diplomave ngrihet niveli ynë ekonomik dhe mbi këtë bazë hedh themelet martesë.* (f. 88)

Heq keq: *Tani Rita nuk do të heqë keq për të kuq buzësh, madamë Elizabeta do t'i dërgojë të kuq buzësh francez.* (f. 189)

Hidhem degë më degë: *Mos u mundo të hidhesh degë më degë dhe t'u hedhësh pluhur fenomeneve.* (f. 62)

Horr i horrave: *Ku më gjete ti, more horr i horrave, që më thua "xhaxha"! (f. 46)*

Humbas toruan: *Ti e ke humbur toruan.* (f. 230)

Hyj në jetën dikujt: *Ka hyrë në jetën time.* (f. 108); *Ndoshta shkëndijat e dashurisë kanë qenë, por ato u shuan qëkur hyre ti në jetën time.* (f. 116)

I bëhet bisht: *Në mbledhje këtyre problemeve iu bë bisht: ju lutem shumë, po na pengoni, ka një kufi.* (f. 14)

I bëj gjyqin: *Dhe e solla këtu, t'i bëjmë gjyqin.* (f. 234)

I bëj kokën: *Po për ne, moj, që të kemi bërë kokën; për babanë tënd, që ka gjithë ato halle, nuk të vjen keq?* (f. 33)

I bie fyellit në një vrimë: *Dhe shiko, Agush, mos i bjerë fyellit në një vrimë, se unë kam vesh muzikor dhe mërzhitem.* (f. 185)

I bie gërnetës: *Po nuk e ndjeve kënaqësinë në punë, bjeri gërnetës sa të duash!* (f. 187)

I bie më qafë: *Të bien më qafë si në konvikt?* (f. 154)

I bie në duar: *Ti, Agush, duke më parë të qeshur, mendon se mund të bie lehtë në duart e burrave!* (f. 108); *Një zuzar elektrikist i bie më qafë vajzës sime.* (f. 47); *Ti i bie më qafë më tepër se duhet.* (f. 120)

I bie të mirës me shqelm: *Do t'i bjerë të mirës me shqelm.* (f. 34)

I çaj kokën: *Mos më çaj kokën dhe ti!* (f. 35)

I çaj kryet: *E ç'më çan kryet!* (f. 31)

I doli e tija: *Patjetër duhet të dalë e tija!* (f. 38)

I doli flaka mbi çati: *Rri, moj të marrtë morti në qoshe, ha një copë bukë si qeni dhe leri të nxjerrin sytë: flaka s'dalka mbi çati?!* (f. 140)

I erdhën mendtë: *Por kur t'i vijnë mendtë Ritës, do të jetë vonë!* (f. 95)

I është bërë koka për brirë: *Koka jote është bërë tamam për brirë.* (f. 135)

I fryn kandilit dhe kandili shuhet: *I fryn kandilit dhe kandili shuhet.* (f. 149)

I fus në një kallëp: *Ne duam që vajzat tona t'i fusim në kallëpin e rehatit.* (f. 11-12)

I futet krimbi: *Ma futi ai mua këtë krimb, Martin.* (f. 168)

I gjej fundin diçkaje: *Fundin nuk ia gjen dot dynjasë.* (f. 134)

I ha bishtin: *Bërr, or të hëngsha bishtin!* (f. 72)

I ha t'ëmën: *Dil, Arsen Burimi, ku je futur, se ta hëngra tët'ëmë!* (f. 235)

I hamë dasmën: *Po dasmën, zonja Zyhra, kur do t'ia hamë çupës?* (f. 42)

I hap syrin: *Ka faj ky, që të hap synë!* (f. 19)

I hap sytë: *Yt atë të ka dhënë shkollë, të ka hapur sytë, dhe ti na... (f. 38); Rinisë t'i hapen sytë.* (f. 60)

I hedh benzinë zjarrit: *I hodhe zjarrin benzinë.* (f. 183)

I hedh një sy: *Faleminderit (e merr gazetën dhe i hedh një sy).* (f. 245)

I hedh pluhur (diçkaje / dikujt): *Mos u mundo të hidhesh degë më degë dhe t'u hedhësh pluhur fenomeneve.* (f. 62)

I hedh sytë: *Sa i hodhi sytë i tha: "Mëlçia e zezë".* (f. 125)

I hedh trutë në erë: *Bektash, koburen, se do t'ia hedh trutë në erë!* (f. 46); *Koburen, Bektash, se do t'ia hedh trutë në erë!* (f. 46)

I heq kapelën: *Ai është inxhinier dhe specialist i zoti, për këtë secili nga ne i heq kapelen.* (f. 23)

I humbas mendjen: *Ma humbi mendjen babai!* (f. 238)

I hyj vendçe: *I hyra vendçe dhe e mbylla në shtëpi.* (f. 18)

I hyn krimbi: *Më hyri në shpirt krimbi i Agushit.* (f. 168)

I hipën kalit me shalë: *Më dukesh si djalë që i hyp kalit me shalë.* (f. 73)

I jap fjalën: *Të jap fjalën.* (f. 251)

I jap një shuplakë: *Se më ka dhënë një shuplakë që do ta ndiej deri sa të vdes.* (f. 261-262)

I jap shkëndijë: *Por ato janë si mjet për t'i dhënë bisedës shkëndijë, për ta bërë më interesante.* (f. 222)

I ka duart të lyera deri në bërryl me gjak: *“Për këtë poet reaksionar rendi ynë socialist është një rend burokratik dhe burokratët i kanë “duart të lyera deri në bërryl me gjak”, “rrëmojnë themelet, lajnë gjakun e dëshmorëve etj. etj.”* (f. 282)

I ka shoqet e rralla: *Por ajo është një grua që i ka shoqet të rralla.* (f. 114)

I kalon kufijtë: *Pas asaj poshtërsie që po bën, poshtërsi që kalon tej kufive të ngushtë, një njeri që përpiqet të prishë një familje dhe kërkon të marrë nëpër gojë njerëz të ndershëm...* (f. 64)

I kam lotët në majë të qerpikëve: *Ja, ju lotët i keni në majë të qerpikëve.* (f. 123)

I kam punët përshesh: *I kam përshesh punët e mia në kantier, ti flet për Fredin e për Ritën!* (f. 160)

I këpus gjuhën: *Bato Barmashi, do të ta këpus gjuhën.* (f. 103)

I kthej krahët: *Ty nesër do të të kthejnë krahët të gjithë dhe do të mbetesh atje në një qoshe.* (f. 180)

I lumshin këmbët!: *Gëzuar e iu lumçin këmbët që erdhët (e ngre gotën).* (f. 217); **I lumshin këmbët!:** *Të lumshin këmbët.* (f. 22)

I marr erë: *U ka marrë erë të gjithëve...* (f. 47)

I marr hua mendimet: *Ti u ke marrë atyre hua mendimet!* (f. 229)

I marr mendjen: *Ia more mendjen Meribanit dhe s'e le të bëhej nusja e djalit tim!* (f. 102)

I marrë hua sytë: *Arsen, ti ke marrë hua sytë e Kikisë për të më parë mua?! (f. 229)*

I mbeti (i vjen) kopili në derë: *Dhe vjen kopili te xha Halili...* (f. 20)

I mbush mendjen: *E di që Agushi ia mbushi mendjen se ti gjoja ke biografi të zezë, se ke pasur një kleçkë.* (f. 96); **Do t'ia mbushim mendjen.** (f. 96); **Ai ta mbushi mendjen** *ty për të të shpënë në kantier pranë Martinit?* (f. 142)

I mbush trupin me mornica: *Rrëmbimi yt, Rita, ma mbushi trupin me mornica.* (f. 181)

I morroçit kokën: *Lëre hapur, e mos na morroçit kokën.* (f. 259)

I ngeli gozhdë: *Do t'i ngelet gozhdë xhaxhait po s'të njohu!* (f. 22)

I përhap nëpër pazar: *Omer, mos i përhap nëpër pazar këto që po të shkruaj.* (f. 276)

I pres krahët: *Mendimeve nuk duhet t'u presim krahët.* (f. 221)

I prish biografinë: *Tani le ta mbajë, se, po ia mora, më prish biografinë!* (f. 239)

I prish gjakun: *Na prish gjakun kot!* (f. 29); *Kur më priset mua gjaku, ju qëndroni sehirxhinj.* (f. 29)

I prish mendjen: *Aman se na prishi mendsh.* (f. 28)

I punoj qindin: *Unë do t'i punoj qindin atij Arsenit.* (f. 236)

I punon gjuha: *Të punon gjuha, o Bat o Baramashi, të punon!* (f. 111)

I rendit të fundit: *Njeri pa perspektivë, inxhinjer i rendit të fundit.* (f. 30)

I tërheq vëmendjen: *Për këtë ka tre muaj që të kemi tërhequr vëmendjen.* (f. 241)

I thyej hundët: *Martini ty t'i thyen hundët, prandaj kërkon ta largosh!* (f. 179)

I vesh me duart e saj: *Me duart e saj i vesh.* (f. 120)

I vë brirë: *Do t'i vërë brirë Fredit!* (f. 111)

I vë gishtin kokës: *Sidoqoftë, ti duhet t'i shkruash Aleksit që t'i vërë gishtin kokës, të mbledhë mendjen e të punojë, ta kapin demin për brirësh!* (f. 49)

I vë gjoksin diçkaje: *T'u vemë gjoksin punëve të mëdha!* (f. 103)

I vë kapak: *Ky i vuri kapak kësaj mbrëmje.* (f. 228)

I vë paterica: *Po i vini paterica, ë?* (f. 76)

I vë shpatullat punës: *Më mirë t'i vëmë shpatullat punës dhe të mos merremi me vogëlsira.* (f. 77)

I vë zjarrin mjekrës, ti nderz cigaren: *Po fundja ai vetë ia vuri zjarrin mjekrës.* (f. 268); *Edhe sikur t'ia ketë vënë vetë zjarrin mjekrës, ne nuk duhet të nderzim cigaren.* (f. 268)

I vërshon mërzia në zemër: *Doemos në zemrën e saj do të vërshojë mërzia.* (f. 160)

I zë furrikun: *Ia zuri furrikun xhaxhait.* (f. 95)

Ia bëj me të pabesë: *Aleksit babai ia ka bërë me të pabesë dhe çndershmërisht.* (f. 38)

Ia bëj mendjen dhallë: *De ore shejtan me brirë, se ma bëre mendjen dhallë.* (f. 73)

Ia lëshoj frerët: *Dhe t'u lëshojmë frerët këtyre hergjeleve?* (f. 19); *Demek, t'ua lëshojmë frerët e të kullosin nga të duan!* (f. 19)

Ia marr shpirtin: *Ajo që thua ti, sa të jem unë gjallë, nuk ndodh, se ia marr shpirtin.* (f. 58)

Ia marrë një dueti: *Para dasmës ia ke marrë një dueti me një zorzop, me një...* (f. 32)

Ia mbyll gojën: *Edhe për hir të asaj që shokët ta mbyllin gojën, unë e pranoj.* (f. 59)

Ia ngul sytë si dervish: *M'i ke ngulur sytë si dervish.* (f. 237)

Ia ngula sytë: *Më kujtove kur të yshta unë, më kujtove ku t'i ngula sytë.* (f. 237); *Unë edhe gurit po ia ngula sytë e bëj të lëvizë.* (f. 237)

Ia prish zemrën: *Ti vetë ia prishe zemrën të birit të botës për vogëlsira.* (f. 26)

Injorancë e lustruar: *Injorancë e lustruar.* (f. 93)

Jam nisur për në Qabe: *Martin, ti pse je nisur për në Qabë, për t'u pastruar?* (f. 175)

Jap mend: *Ne të tjerëve dimë t'u japim mend, po për vete...* (f. 31); *Kujt i kam dhënë mend, moj fantazore?* (f. 31); *U kam shfaqur mendimin tim, por nuk u kam dhënë mend.* (f. 31)

Ka ca damarë: *Eh, i urtë, more i urtë, po ka ca damarë njeriu që, po i kërcyen, bën hatanë (çiften e ka harruar në dorë).* (f. 235)

Ka gisht të bukur: *Gjish të bukur që paska!* (f. 16)

Ka një dërrasë mangët: *Zaten shkencëtarët e kanë një dërrasë mangut.* (f. 240)

Ka një kufi: *Në mbledhje këtyre problemeve iu bë bisht: ju lutem shumë, po na pengoni, ka një kufi.* (f. 14)

Ka qejf: *Por ke parë ti, si vetë, si gruaja, të gjithë e kanë qejf kitarën.* (f. 16)

Ka rënë poshtë: *Sa poshtë ke rënë, Arsen.* (f. 229)

Kalli pa bukë: *Kalli pa bukë!* (f. 40)

Kam diplomën në xhep: *E nxit diploma që ka në xhep.* (f. 30)

Kam mendjen diku: *Kushedi ku e ka pasur mendjen (heq kitarën nga qafa dhe shikon në dritaren e ndezur): T'u jap një sinjal me kitarë?* (f. 144)

Kam mendjen time: *Kam edhe unë mendjen time.* (f. 261)

Kam qejf: *Unë i kam qejf ujërat të pastra.*

Kam turp: *Të kesh turp!* (f. 38)

Kam vesh muzikor: *Dhe shiko, Agush, mos i bjerë fyellit në një vrimë, se unë kam vesh muzikor dhe mërzitem.* (f. 185); *Edhe vesh muzikor kam pasur, por nga dembellëku s'i jam vënë ta mësoj.* (f. 187)

Kam zemrën si të zogut: *Si të zogut e kam zemrën.* (f. 141)

Kërkon qimen në vezë: *Ky kërkon të gjejë qimen në vezë!* (f. 217)

Koburja e varur duhet të zbrazet. *fj. u.: Koburja e varur duhet të zbrazet.* (f. 152)

Kripa në tokë, peshku në det: *Kripa në tokë, peshku në det, po një tigan i bashkon.* (f. 42)

Ku e lyp nevoja: *Njeriu duhet të shkojë atje ku e lyp nevoja.* (f. 37)

Kulturë e dështuar: *Ik more, kulturë e dështuar.* (f. 93)

Kulloj nga sytë: *Kullove nga sytë moj e gjorë.* (f. 214)

Kur e ke tokën të lëruar, e gjen dhe farën *fj. u. Kur e ke tokën të lëruar, e gjen dhe farën.* (f. 42)

Lan gjakun e dikujt: *“Për këtë poet reaksionar rendi ynë socialist është një rend burokratik dhe burokratët i kanë “duart të lyera deri në bërryl me gjak”, “rrëmojnë themelet, lajnë gjakun e dëshmorëve etj. etj.”* (f. 282)

Leri, Shero, nazet, s’të kanë lezet: *Leri, Shero, nazet, s’të kanë lezet (i reciton si vargje).* (f. 159)

Lë në baltë: *Ti, i dashur Bektash, së bashku me Muhametin, e keni lënë Aleksin krejt në baltë.* (f. 63)

Lëron tokën dhe e humbet farën: *E lëron tokën dhe e humbet farën (hedh sytë nga shishja e rakisë, Zyhraja përgatit tavolinën).* (f. 42)

Luaj mendsh: *Liza, lojte mendsh?* (f. 107); *Nuk lojta!* (f. 107); *I bën ca naze Kamber Shtikës dhe ai luan mendsh.* (f. 108); *Lojte mendsh, Fredi?!* (f. 135); *Mos bëj shaka, se po më luan mendsh.* (f. 51); *Thuaji se ka luajtur mendsh.* (f. 33); *Ai Aleks, për të cilin po luan mendsh ti, ia ka bërë me të pabesë tyt eti.* (f. 38)

M’u prish gjaku: *Bereqet kemi, o kusho, po na është prishur gjaku me këto vajza që kemi.* (f. 40) *Sa herë të prishet gjaku, ti vjen në Tiranë.* (f. 40)

M’u thaftë këmba!: *Oh, m’u thaftë këmba m’u thaftë.* (f. 231-232)

Ma do zemra: *O kolopuçi i xhaxhait, sa ma dashka zemra!* (f. 76)

Ma mbush mendjen: *Pastaj Agushi ma mbushi mendjen se puna jote e re në kantier do të të ngjallë kënaqësi.* (f. 177)

Ma merr mendja: *Ma mori mendja që do të përfundonte keq.* (f. 112); *Ma mori mendja se do të ishte dhëndri.* (f. 22); *Meriban, si ta merr mendja, do të jetë dobësuar Rita?* (f. 145)

Malli i babait: *Se mos ne po diskutojmë për mallin e babait!* (f. 80)

Marr frymë: *Prit, bre, merr frymë!* (f. 241)

Marr me mend: *Nuk e merrja me mend të të prisja sonte!* (f. 211)

Marr mendjen e dikujt: *Mora mendjen tënde.* (f. 200)

Marr nëpër gojë: *As Andrea, as Kristina, nuk ka pse të merren nëpër gojë.* (f. 24); *Pas asaj poshtërsie që po bën, poshtërsi që kalon tej kufijve të ngushtë, një njeri që përpiqet të prishë një familje dhe kërkon të marrë nëpër gojë njerëz të ndershëm...* (f. 64)

Marr vesh (diçka): *Gjërat që ndodhin në këtë shtëpi unë i marr vesh i fundit.* (f. 29); *Çfarë ke marrë vesh ti, Bektash?;* (f. 29) *Qëkur u fejua me Muhamedin, dhe unë sot e marr vesh!* (f. 30); *Po Muhameti, moj, po sikur ta marrë vesh Muhameti?* (f. 33); *Po ti xhaxha, u nxehe kur more vesh se unë u martova me Aleksin?* (f. 75); *Seç the sot, asnjëri nuk e mori vesh.* (f. 15); *Po*

ku e morën vesh që u ktheva në shtëpi! (f. 20); *E le ta marrë vesh dhe ky!* (f. 203); *E more vesh vendimin tim?* (f. 181); *Edhe kur i lexoj, edhe kur i dëgjoj, unë mezi i marr vesh.* (f. 223); *I kam marrë vesh të gjitha.* (f. 231); *S'të marr vesh!* (f. 239)

Mbaj erën e dikujt: *Mbajti erën tënde.* (f. 100)

Mbaj mendjen time: *Mbaje mendjen tënde.* (f. 262)

Mbledh mendjen: *Sidoqoftë, ti duhet t'i shkruash Aleksit që t'i vërë gishtin kokës, të mbledhë mendjen e të punojë, ta kapin demin për brirësh!* (f. 49)

Mbledh xhindet: *Zonja Zyhra, ç'është ky zorzopi që i bie qitharës tashti natën, sikur mbledh të gjithë xhindet?* (f. 16)

Me biografi të mirë: *Nga një derë me biografi të mirë.* (f. 18)

Me biografi të zezë: *E di që Agushi ia mbushi mendjen se ti gjoja ke biografi të zezë, se ke pasur një kleçkë.* (f. 96)

Me forcën e krahut: *Ke punuar me mend në kokë, i ke gjetur një basho vend, me forcën e krahut tënd!* (f. 21)

Me goditje të largët: *Nuk janë si të llafazanëve, janë me goditje të largët.* (f. 48)

Me gjak të ftohtë: *Rishikojeni me gjak të ftohtë si historinë e fejesës së Arianës dhe historinë e mundimeve që i keni shkaktuar asaj, dhe keni për të kuptuar diçka.* (f. 65)

Me gjithë mend: *I thua me gjithë mend a i thua me shaka.* (f. 236)

Me marrtë dreqi: *E mori dreqi këtë punë, thashë me vete.* (f. 18)

Me mend në kokë: *Ke punuar me mend në kokë, i ke gjetur një basho vend, me forcën e krahut tënd!* (f. 21)

Me një të lëvizur të stilolapsit: *E di se ku e degdis atë unë, me një të lëvizur të stilolapsit?* (f. 50)

Me sy të qeshur: *Fatbardha nis të tundë lehtë karrocën e, pasi ndjek me sy të qeshur plakun që largohet avash sikur trembet se mos thyejë vezë, e kthen vështrimin nga libri e thellohet në të.* (f. 200)

Me tërë kuptimin e fjalës: *Ti me Muhametin do të bësh jetë, me tërë kuptimin e fjalës.* (f. 34)

Merr erë: *Kam frikë se kjo punë do të marrë erë dhe Martini do të ndëshkohet rëndë nga organizata, nga komiteti e nga të gjithë!* (f. 162)

Më bëhen sytë ujë: *Iu bënë sytë ujë, të ziut!* (f. 17)

Më bën mirë: *Të bëftë mirë, zoti Halil!* (f. 39)

Më bie bretku: *Jo, jo, ne na binte bretku në punë.* (f. 119)

Më bie tavani mbi kokë: *Na ra tavani mbi kokë!* (f. 228); *Po mua nuk më ra tavani mbi kokë, kur tha ky Kamani yt se shkenca u bëka këtu dhe në fshat u merrkeshin me vogëlsira?* (f. 228)

Më bluan mulliri: *Na bluan ky qerrata mulli, na bluan dhe nuk e dimë se ç' miell nxjerrim.* (f. 27)

Më del nga mendja: *S'ju kam thënë deri tani se më doli nga mendja.* (f. 22)

Më digjet lëkura: *Ai e provoi një herë se sa i dogji lëkura dhe nuk besoj ta ndezë përsëri.* (f. 268)

Më doli inati: *Do t'i dalë inati.* (f. 74)

Më duket çudi: *Të duket çudi?* (f. 29)

Më dhemb koka: *Sa më dhemka zemra, moj mbesë!* (f. 75)

Më hapet koka: *M'u hap koka.* (f. 132)

Më hëngri veshët: *Kjo plaka ime më hëngri veshët: "Të shkojmë te Rita, të shkojmë te Rita" (ulet në poltron).* (f. 146)

Më hipën xhindet: *Më hipin xhindet e fillojnë të më dridhen këto të shkreta (tregon mustaqet).* (f. 18); *Ç' dreqin ju hipën xhindët në kokë?* (f. 184)

Më hyn në zemër: *E si të mos ndodhte, more Bektash, kur ty filloi të të pëlqejë vetja; kur ty filloi të të hyjë në zemër më tepër karrigja se sa preokupimet e punës së njerëzve!* (f. 80)

Më ka hyrë në palcë: *Metodat e vjetra të punës na kanë hyrë në palcë.* (f. 56)

Më kall krupën: *"Ai që më keni zgjedhur ju mua më kall krupë", më thotë.* (f. 18)

Më kërcen gjaku i lashtë: *Ç' të kërcëu ky gjak i lashtë!* (f. 235)

Më marrsh pleshtat: *Na marçi pleshtat.* (f. 108)

Më mbeti koka: *Më mbeti koka nga dera.* (f. 186)

Më mblidhet rreth kokës diçka: *M'u mblodhën rreth kokës mbeturinat borgjeze dhe më trazuan shumë.* (f. 75)

Më mbush mendjen: *Ti e di që unë ia mbusha mendjen...* (f. 184); *E di si ia mbushe mendjen.* (f. 184)

Më mbushet mendja top: *Duhet të të mbushet mendja top ty dhe kujt do tjetër që Aleks i asnjë poshtërsi nuk ka bërë.* (f. 64)

Më ngrihen mustaqet përpjetë: *M'u ngritën mustaqet përpjetë!* (f. 239)

Më ngjitet fitili: *Hë, më të keqen Halili, si qenka ngjitur fitili!* (f. 21)

Më nxiu faqen: *"S'je bërë akoma ti, aguridhe, që t'i nxish faqen Halil Shkozës!* (f. 18)

Më nxjerr miell mulliri: *Na bluan ky qerrata mulli, na bluan dhe nuk e dimë se ç' miell nxjerrim.* (f. 27)

Më prish mendsh: *Na prishe mendsh, dreqi të martë!* (f. 239)

Më prishet gjaku: *Edhe unë nuk ua vë veshin, por kur përsëriten ditë për ditë më bëjnë nervoz dhe më prishin gjakun.* (f. 137); *Qëkur na ndodhi ajo gjëma, iu prish gjaku e mori poshtë e më poshtë.* (f. 17)

- Më rreh mendja diku:** *E dini se ku më rreh mendja mua?* (f. 89)
- Më shkon mendja diku:** *Ku të shkon mendja, Agush!* (f. 161)
- Më shkon mendja për keq:** *Unë ty të dua dhe ndoshta prandaj mendja më shkon gjithnjë për të keq.* (f. 143)
- Më vete gjuha:** *Më fal, Bato, por pa dashur na vete gjuha, sepse jemi marrë shumë me këtë çështje dhe nuk na hiqet nga mendja.* (f. 185)
- Më vete mendja për diçka:** *Nuk më vete mendja në femra.* (f. 154)
- Më vërtitet mendja:** *Mendja ime nuk vërtitet vetëm rreth tavolinës.* (f. 226)
- Më vjen e hidhur (diçka):** *Tani do të t'i numëroj të gjitha dhe do të të vijë hidhur e vërteta.* (f. 29)
- Më vjen në majë të hundës:** *Në majë të hundës më ka ardhur!* (f. 126)
- Më vjen rrotull:** *“Me kë je mollokrepsur, moj sojzezë, me elektrixhiun që ka filluar t'i vijë rrotull shtëpisë?”* (f. 18)
- Më vjen turp:** *Tani më vjen turp kur më thonë.* (f. 238)
- Më zënë sytë:** *Ngadonjëherë miqësia që kemi na zë sytë dhe nuk na le të shohim fenomenet që na rrethojnë.* (f. 24)
- Më zien koka:** *Mua, Bato, më zien koka nga problemet e ndërtimit.* (f. 154)
- Më zien koka:** *Po ç'të bëjmë, më zien koka!* (f. 57)
- Më zien në gjoks:** *Inati i mbledhjes ende po të zien në gjoks.* (f. 49)
- Minierë e thellë:** *Fakt i pamohueshëm, njeriu qenka një minierë e thellë, sa më tepër... (f. 14); Ti vetë e ke thënë se njeriu është një minierë e thellë.* (f. 52)
- Mori poshtë e më poshtë:** *Qëkur na ndodhi ajo gjëma, iu prish gjaku e mori poshtë e më poshtë.* (f. 17)
- Mos e dhëntë zoti!:** *Mos e dhëntë zoti!* (f. 140)
- Mos t'i pafsha sytë:** *Dhe mos të t'i shoh sytë!* (f. 135)
- Mu bë ferrë:** *Hë, more Astrit shkencëtari, që më je bërë ferrë.* (f. 240)
- Mua më digjet mjekra, ti do të ndezësh cigaren:** *Atij i digjet mjekra, unë shkoj të ndez cigaren!* (f. 268)
- Ndërroj mendje:** *Edhe parmbremë nuk doje të dilje me të zotrote, ndërrove mendje.* (f. 25)
- Ndizet e shuhet:** *Ndizet e shuhet.* (f. 149)
- Ndjek rrugë të dëmshme:** *Se ti je një nga ushqyesit moralë të saj për të ndjekur një rrugë të dëmshme.* (f. 29)
- Në fund të fundit:** *Në fund të fundit, njeriu duhet të shkojë atje ku e lyp nevoja.* (f. 37)
- Në nerva e sipër:** *Njeriu, në nerva e sipër, çdo gjë mund ta thotë.* (f. 58)
- Në një pikë të vdekur:** *Gjendja jote shpirtërore është në një pikë të vdekur.* (f. 172)

Në sy të të gjithëve: *Hajde të të puthë Bato Barmashi në sy të të gjithëve!* (f. 97)

Ngre dorë: *Tani nuk më lejojnë parimet e mia morale të ngre dorë mbi ty, pasi ngre dorën mbi postin që ti mban.* (f. 158)

Ngre në këmbë: *Ngrite në këmbë mëhallën!* (f. 31)

Ngre një gotë: *Kiki, hajde se do të ngremë një gotë për të zotin e shtëpisë.* (f. 214)

Ngre veshët: *Skutash e qoshesh ata ngrënë veshët, / Skutash e qoshesh pritë ju zënë.* (f. 105); *Të dashura vajza, / Ruhuni nga mblesët, / Mblesët e dhjamur, / Mblesët thatimë, / Mblesët që ngrënë skutave veshët, / Dhe skutave tjerrin të zeza mendime.* (f. 106)

Ngul këmbë: *Ka ardhur shoku Omer Kreshta dhe ngul këmbë me të madhe që t'ju takojë, kërkon t'ju japë një dokument shumë të rëndësishëm.* (f. 270)

Ngul këmbë: *Ne bëmë gabim që ngulëm këmbë për ta fejuar.* (f. 30); *Dhjetë kërkesa ju kemi bërë dhe ju ngulni këmbë në tuajën.* (f. 56); *Dhe ju ngulni këmbë që të mos bëhet asnjë ndryshim, sikur ta kishit bërë vetë projektin.* (f. 56); *Unë ngul këmbë.* (f. 66); *Pse ngul këmbë të ikim?* (f. 191)

Nuk e çaj kokën: *Ja, thotë se nuk po e çajmë kokën për të.* (f. 130)

Nuk e vras mendjen: *E po unë nuk po e vras mendjen.* (f. 206)

Nuk hedh fall: *Çupa e Andreas nuk hodhi fall se do emërohej në Laç.* (f. 11)

Nuk i hedh sytë: *Të jem unë, as sytë nuk ia hedh.* (f. 92)

Nuk i kam frikën: *Ngadalë xhaxha, ngadalë, se nuk ta ka njeri frikën!* (f. 46)

Nuk i kam parë as në ëndërr: *Problemet e tyt eti nuk i ka parë as në ëndërr...* (f. 38)

Nuk i pi ujë: *Ai duhet ta kuptojë se kjo nuk i pi edhe aq ujë.* (f. 253)

Nuk ia vë re: *Muhamet, të keqen, mos ja vër re zotit Halil.* (f. 23)

Nuk ia vë veshin diçkaje: *Në përgjithësi nuk ua vë veshin thashethemeve.* (f. 137); *Edhe unë nuk ua vë veshin, por kur përsëriten ditë për ditë më bëjnë nervoz dhe më prishin gjakun.* (f. 137)

Nuk ka brirë: *Po dashuria nuk ka brirë, mor kushëri.* (f. 26)

Nuk ma mbush mendjen: *Po nuk bëjnë katër nuk ma mbushin mendjen.* (f. 171)

Nuk ma merr mendja: *Nuk ma merr mendja që ju me Kristinën të keni vepruar në këtë mënyrë...* (f. 48); *Por që të arrinte deri këtu nuk ma merrte mendja.* (f. 69); *S'ma merrte mendja të të shihja këtu.* (f. 71); *Që të arrinte Arseni gjer në këtë shkallë, nuk ma merrte mendja.* (f. 234)

Nuk mbaj inat: *Xhaxhait iu martua çupa me dashuri, por nuk mban inat.* (f. 74)

- Nuk merr vesh:** *Atij i thotë Engelsi, ai s'merr vesh!* (f. 256)
- Nuk më del inati:** *Jemi soj që nuk na del kollaj inati.* (f. 74)
- Nuk më hiqet nga mendja:** *Më fal, Bato, por pa dashur na vete gjuha, sepse jemi marrë shumë me këtë çështje dhe nuk na hiqet nga mendja.* (f. 185)
- Nuk më hiqet nga mendja:** *Mua s'më hiqet nga mendja fytyra e tij, gjithë qenia e tij, me tërë peshën e dhimbjes së madhe.* (f. 247)
- Nuk më mbajnë nervat:** *Nuk më mbajnë nervat.* (f. 258)
- Nuk ngre kokën:** *Dhe si i pushkatuar nuk mund ta ngre kokën.* (f. 268)
- Nuk të merren vesh:** *Nuk të merren vesh fjalët ty, baba!* (f. 236)
- Nxjerr mjaltë nga goja:** *"Po ku gjen djalë më të mirë se Hyska i Selos, moj, i them unë: me familje të mirë, me vëllezër të martuar, me një baba që nxjerr mjaltë nga goja".* (f. 18)
- Nxjerr nga shtëpia:** *Yt atë, katrani, më nxirrte nga shtëpia po të gjente rrëmujë.* (f. 119)
- Nxjerr sytë:** *Rri, moj të marrtë morti në qoshe, ha një copë bukë si qeni dhe leri të nxjerrin sytë: flaka s'dalka mbi çati?!* (f. 140)
- Njeri me dërrasë në kokë:** *Njeri me dërraskë në kokë!* (f. 30)
- Njeri pa gjak:** *Je pa gjak, Vili!* (f. 173)
- Njeri pa zemër:** *Vili, ti je njeri i thatë, njeri pa zemër!* (f. 171)
- Një lehonë nxjerr nëntë binjakë:** *Mirë xhanëm, po kjo më duket sikur thonë një lehonë nxori nëntë binjakë.* (f. 206)
- Pa din e pa iman:** *Yh, tradhtar, pa din e pa iman!* (f. 262)
- Pa iu tharë boja e shtypshkronjës:** *Unë lexoj vetëm autoritete e vetëm pasi kanë bërë bujë, kurse kjo i hap librat pa iu tharë boja e shtypshkronjës.* (f. 201)
- Pemë e madhe me degë të gjata:** *Pemë e madhe me degë të gjata.* (f. 41)
- Për faqe të zezë:** *Po e kemi dhomën për faqe të zezë, mor vëllezër!* (f. 87)
- Pështyn në çorbë:** *Po na pështyn në çorbë ky, more Bektash!* (f. 53)
- Pi gotat e hidhërimit:** *Kam pirë gotat e hidhërimit tënd.* (f. 182)
- Po të zihesh me burimin, vdes për ujë:** *Po të zihesh me burimin, vdes për ujë.* (f. 41)
- Poet korbash:** *Me keqardhje ky poet korbash thotë se "topa, himne e valle ka kundër armiqve" por "kundër burokracisë s'ka konsuj".* (f. 282)
- Pres ditën e dasmës:** *Premë ditën e dasmës, ftuam soj e sorollop, kaparosëm edhe sazexhinjtë.* (f. 18)
- Prish shtëpinë:** *Eh, moj nuse, ç'na e prishe shtëpinë!* (f. 135)
- Prish vetë Pejgamberin!:** *Ju prishni vetë Pejgamberin e jo Zalon e shkretë.* (f. 102)
- Prishja e gjakut:** *Përveç të këqijave të prishjes së gjakut dhe dobësimit të nervave, objektivisht asgjë të mirë nuk sjellin këto thashetheme.* (f. 62)

Prit gomar të mbijë bar: *Prit gomar të mbijë bar.* (f. 14)

Pyll pa derra nuk ka fj. u.: *Pyll pa derra s'ka...* (f. 239)

Qentë le të lehin, karvani të shkojë përpara fj. u.: *Mua kjo s'm'u durua pa e thënë, për të treguar atë që karvani të shkojë përpara, pa qentë le të lehin.* (f. 242)

Robot i telekomanduar: *Ti je një robot i telekomanduar nga Kamani.* (f. 230)

Romantik i vetmuar: *Po më dukesh si ata romantikët e vetmuar, Omer.* (f. 208)

Ruaj nderin: *Nuk dua të më ruash ftesat, por nderin.* (f. 32)

Rrah ujë në havan: *Për çupën e Andreas u fol kot. Ujë në havan.* (f. 12)

Rreh diku: *E di unë ku rreh ai!* (f. 107)

Rreh ujë në havan: *Ujë në havan...* (f. 210)

Rrëmon themelet e diçkaje: *“Për këtë poet reaksionar rendi ynë socialist është një rend burokratik dhe burokratët i kanë “duart të lyera deri në bërri me gjak”, “rrëmojnë themelet, lajnë gjakun e dëshmorëve etj. etj.”* (f. 282)

Sa të hap gojën: *Mos mendo se ti je yll dhe ne femrat presim sa të hapësh gojën e të biem në krahët e tu: “Aman, o Agush, na uth me buzët e tua, se plasëm!”* (f. 109)

Sa të piqet buka në saç: *Të presim derisa të piqet buka nën saç!* (f. 57)

Sa të pish një paketë cigare: *E di ti, shoku drejtor i fabrikës së tullave, se për pesë-gjashtë fillon drenazhimin e tokave në fushë dhe ato që ke planifikuar ti mbarojnë sa të pish një paketë cigare.* (f. 240)

Sa vë buzën në gaz: *Fredi sa vë buzën në gaz dhe përsëri merr pamje serioze, aq sa mund ta marrë këtë pamje një njeri i bërë më qejf nga rakia.* (f. 151)

S'e marr vesh: *S'e marr vesh!* (f. 158)

Sfungjer me qindra sy: *Sfungjer me qindra syçka.* (f. 42)

Si buka që hamë: *Është e vërtetë si buka që hamë.* (f. 59)

Si çobani pa balon: *Batua pa Zalon, si çobani pa balon!* (f. 105)

Si dashi pa këmborë: *Njeriu pa dashnore, si dashi pa këmborë.* (f. 105)

Si hënë pesëmbëdhjetëshe: *E vërtetë e plotë, si hëna pesëmbëdhjetëshe.* (f. 57)

Si i prishur në fytyrë: *Të shoh si të prishur në fytyrë.* (f. 133)

Si i rënë nga qielli: *Ky Hyska, moj Zyhra, si i rënë nga qielli.* (f. 18)

Si kalë bashkie: *Ti e merr kallëp, si kalë bashkie.* (f. 123); *Më fal se të thashë “si kalë bashkie”.* (f. 123)

Si lugat i zi: *Më del Batua si lugat i zi nga tymi e bloza: “T'u bëftë Batua, më thotë, hajde të të verë Batua pak pomadë të zezë në faqet e tua të bëshme”.* (f. 150)

Si macja me miun: *Grindet me mua si macja me minë dhe nuk ka qejf të ndahet me ngrohtësi e humor nga unë.* (f. 183)

Si stivë drush: *Unë dua kurajo, ju rrini si stivë drush.* (f. 172)

Si shihet macja me miun: *Një filozof ka thënë: “Gruaja me burrin, në çastet kur jeta e vrullshme kthehet në monotoni, mërzhiten dhe e shofin shokushokun siç shihet macja me minë”.* (f. 147)

Sikur të hidhesh majë trarit: *Edhe sikur ti të hidhesh majë trarit, unë do të zgjedh punën time, pasionin tim.* (f. 143)

Sjell nëpër mend: *Eh, mor Zeqo, ç’kohëra po sjell nëpër mend.* (f. 45)

S’jemi si këmbët e dhisë: *Dale-o, se s’jemi si këmbët e dhisë!”* (f. 151)

S’më ka marrë malli për sytë e tu: *Edhe mua s’më ka marrë malli për sytë e tu!* (f. 135)

Soletë ferrobetoni: *Jo tra, por soletë ferrobetoni.* (f. 45)

Shejtan me brirë: *De ore shejtan me brirë, se ma bëre mendjen dhallë.* (f. 73)

Shfletoj me mendje diçka: *Në prita shfletojnë me mendje kanunë, / Kafën e pinë me të liga mendime.* (f. 105)

Shkulen gazit: *Kështu flet ky, nuk e ke dëgjuar më parë pa do të shkuleshe gazit.* (f. 23)

Shtie në dorë: *Rita e rrëzoi perandorinë e Marikës, i mori qeverisjen e shtëpisë, çelësat e kasafortës së shtëpisë i shtiu në dorë Rita, se ajo është forcë prodhuese.* (f. 160)

Shtrij nën këmbë diçka Ke shtrirë personalitetin tënd nën këmbët e Kaman Kalasë. (f. 230)

Të ardhhtë qafa mbrapa: *I ardhhtë qafa mbrapa!* (f. 16)

Të lumtë gisht!: *Të lumtë gishti, Bato Barmashi.* (f. 186)

Të lumtë goja: *Të lumtë goja, Bato Barmashi.* (f. 186)

Të marrtë mortja!: *Rri, moj të marrtë mortin në qoshe, ha një copë bukë si qeni dhe leri të nxjerrin sytë: flaka s’dalka mbi çati?!* (f. 140)

Të punoni për vendin e për pushtetin që ju hapi sytë. (f. 102)

Tjerr mendime të zeza: *Të dashura vajza, / Ruhuni nga mblesët, / Mblesët e dhjamur, / Mblesët thatimë, / Mblesët që ngrenë skutave veshët, / Dhe skutave tjerrin të zeza mendime.* (f. 106)

Trazoj plagën: *Vetë e trazon plagën dhe pastaj thua “më dhemb”.* (f. 48)

T’u mbylltë e mendjes!: *Po telefonin në shtëpi, pse e ke, moj t’u mbylltë e mendjes!* (f. 68)

Tund zinxhirin: *Drejtoni ju, apo tundni zinxhirin?* (f. 14)

Thatësirë pa pikë uji: *Thatësirë pa pikë uji!* (f. 170)

Thyej vezë: *Fatbardha nis të tundë lehtë karrocën e, pasi ndjek me sy të qeshur plakun që largohet avash sikur trembet se mos thyejë vezë, e kthen vështrimin nga libri e thellohet në të.* (f. 200)

U jap ngjyrë: *Mos u jep ngjyrë komike problemeve.* (f. 15)

U ngopa gjer në fyt: *Aman, more shoku Bektash, se u ngopëm gjer në fyt me përrallat tuaja!* (f. 56)

U pres rrugën: *Dhe jo vetëm që nuk ka ndërhyrë tek Aleks, që t'u presë rrugën këtyre meskiniteve, por, me sa më duket mua, i ka inkurajuar.* (f. 59)

Udha e mbarë! *Na dhe ti një gotë me verë dhe na uro udhë të mbarë.* (f. 102)

Ujëra të pastra: *Unë i kam qejf ujërat të pastra.* (f. 210)

Ushtar i thjeshtë: *Për dy vjet Agushi u bë shef, kurse ti, edhe njëqind vjet të jetosh, ushtar i thjeshtë ke për të mbetur.* (f. 148)

Ushtar i thjeshtë: *Ushtar i thjeshtë, Kaman, ushtar i thjeshtë.* (f. 214)

Vafsh në djall!: *Nuk ke vajtur në djall!* (f. 231)

Var buzët: *Po ti, moj çupë e xhaxhait, ç'm'i ke varur buzët?* (f. 21)

Vë këmbë: *Çdo gjë në këtë dhomë ka një rregull të ftohtë, aq sa ke frikë të vësh këmbët, se kushedi mund të prishësh simetrinë, mund të çrregullosh diçka.* (f. 118)

Vë kujën: *E po nuk do të vërë kujën për hiçgjë!* (f. 130)

Vë në buzë: *Ky s'e paska vënë fare në buzë!* (f. 25)

Vë në dyshim: *Mirëpo ftohja e saj më ka vënë në dyshim.* (f. 36)

Vë në jetë: *Nuk është vonë, ato propozime mund t'i vësh në jetë.* (f. 51)

Vë në lojë: *Ti je aq i zgjuar sa t'ua vesh në lojë megalomaninë e tyre të padurueshme dhe nihilizmin meskin.* (f. 213)

Vë re: *Këtë e kam vënë re edhe unë, si koleg i vjetër i tij.* (f. 209)

Vras mendjen: *Dëgjomë mua ti, mos e vrit mendjen shumë.* (f. 134)

Vulë e ligë: *Ti derën tonë po e vulos me një vulë të ligë, që s'fshihet kurrë.* (f. 32)

Zbardh dhëmbët: *Ç'zbardh dhëmbët, moj pipiruçe!* (f. 102); *Dhe burrat si guakë i shkojnë dhe zbardhin dhëmbët...* (f. 119); *Djali i sëmurë, nusja sa them unë një fjalë zë e zbardh dhëmbët.* (f. 132)

Zbardhja e dhëmbëve: *Po, po, shoqërore janë edhe zbardhjet e dhëmbëve me Martinin në mes të mapos së qytetit, në mes të njerëzve!* (f. 143)

Zë mend: *Akoma nuk kemi zënë mend?!* (f. 55)

Zë në gojë: *Bato Bermashi, po ta them që ta dish: nuk dua të ma zësh në gojë Ritën!* (f. 96); *Kemi objekte më të rëndësishme për të zënë në gojë.* (f. 49); *Ju jeni bërë pengesë e madhe për këtë hap që zutë në gojë.* (f. 55); *Edhe Bektashi i zë në gojë këto mbeturinat.* (f. 76); *Emrin e Arianës nuk e shoh të nevojshme ta zëmë në gojë.* (f. 77); *Mos ma zërë në gojë atë qen.* (f. 139)

Zë vend: *Dhe shef Fatja, apo shef Agushi, do të zinin vend në krye të tavolinës!* (f. 101)

Zjarr për çibuk: *Zjarr për çibukun, Bektash!* (f. 43)

Zog nga vendet e ftohta: *Zogj nga vende të ftohta!* (f. 153)